



# Të gjitha njohuritë që janë të rëndësishme për dokumentin elektronik të lejeqëndrimit (eAT)



[www.bamf.de/eaufenthaltstitel](http://www.bamf.de/eaufenthaltstitel)







# Përmbajtja



1	Dokumenti elektronik i lejeqëndrimit	5
2	Fotografia dhe gjurmët e gishtave	7
3	Dispozitat shtesë (kushtet e veçanta)	9
4	Funksioni i legjitimitit-online	10
5	Nënshkrimi elektronik	13
6	Mundësi të reja të përdorimit të dokumentit Tuaj të lejeqëndrimit	15
7	Siguria e të dhënave	16
8	Çfarë ndodh në rast vjedhjeje apo humbjeje?	17
9	Çfarë ndodh, nëse ...	18
10	Ne jemi aty për ju!	19

# Hyrje

Dokumenti, që iu është dhënë Juve nga organet e Zyrës për të huaj (lejqëndrimi, leja e vendosjes, lejqëndrimi permanent-EG dhe Kartoni i Kaltër EU), deri më tani është ngjitur si etiketë në dokumentin Tuaj të udhëtimit.

Nga 1 shtatori 2011 do të lëshohet në qarkullim dhe do të dorëzohet “dokumenti elektronik i lejqëndrimit” (eAT) si një dokument i veçantë në formatin e një kartele krediti me funksione elektronike shtesë. Ky dokument do të lëshohet në qarkullim për të gjithë pjesëtarët e shteteve të treta si një dokument i veçantë.

E njëjta procedurë vlen edhe për vërtetimet mbi të drejtën e qëndrimit (kartela e qëndrimit, kartela e qëndrimit me kohëzgjatje dhe lejqëndrimi për zvicëranët), të cilët deri më tani janë lëshuar si dokumente të veçanta në format letre për pjesëtarët e qytetarëve të UE-së dhe zvicëranëve me gjithë pjesëtarët e familjeve të tyre.

Në brendinë e kartelës eAT-ja ka një çip të zakonshëm, në të cilin janë të ruajtura tiparet biometrike (fotografia dhe pas moshës 6-vjeçare dy gjurmët e gishtave), dispozitat shtesë (kushtet e veçanta) dhe të dhëna personale. Çipi gjithashtu përmban një dëshmi elektronike mbi identitetin si dhe mundësinë për të shfrytëzuar një sinjaturë elektronike.

## Dokumenti elektronik i lejqëndrimit në një vështrim

- Lëshimi në qarkullim më 01 shtator 2011
- E zëvendëson etiketën ngjitëse të deritanishme
- Standardizimi mbarevropian i dokumentit të lejqëndrimit për të gjithë të huajt, të cilët nuk janë shtetas të Unionit Evropian (= pjesëtarët e shteteve të treta)
- Format të një kartele krediti
- Çip i zakonshëm në brendinë e kartelës
- Mbrojtje nga falsifikimi dhe keqpërdorimi përmes një fotografie digjitale dhe gjurmëve të gishtërinjve nga mosha gjashtë vjeçare, kjo flet qartë, se dokumenti i lejqëndrimit i atribuohet plotësisht vetëm poseduesit të vet
- Funksion elektronik identifikimi për punë afariste/aktivitetet në internet dhe në automatet e ndryshme
- I përgatitur për sinjaturën elektronike për nënshkrimin ligjor të dokumenteve digjitale



# 1 Dokumenti elektronik i lejeqëndrimit



## Përse lëshohet në qarkullim eAT-ja?

Për futjen në qarkullim të eAT-së janë të obliguara të gjitha shtetet anëtare të EU-së. Bazë për këtë janë urdhëresat e UE-së Nr. 1030/2002 dhe Nr. 380/2008. Synim parësor është, që të bëhet standardizimi i dokumenteve të lejeqëndrimit të Unionit Evropian për pjesëtarët e shteteve të treta si dhe për ta forcuar dukshëm lidhjen midis poseduesit të dokumenteve dhe dokumentit nëpërmjet të shfrytëzimit të të dhënave biometrike dhe me këtë për ta mbrojtur nga keqpërdorimi i mundshëm.

## A e ruajnë vlefshmërinë dokumentet e vjetra të lejeqëndrimit?

Titujt e deritanishëm të lejeqëndrimit në pasaporta dhe në fleta shtesë e ruajnë vlefshmërinë e tyre më së voni deri më 30.04.2021.

## Sa kohë është e vlefshme një eAT?

Vlefshmëria e eAT-së varet nga lloji i dokumentit të lejeqëndrimit, respektivisht të vërtetimit mbi të drejtën për të huajt dhe vendimit ligjor të organeve të Zyrës për të huajt. Te dokumentet e paafatizuara të lejeqëndrimit, shfrytëzimi i kartelës është i kufizuar në dhjetë vjet. Pas dhjetë vjetësh duhet të lëshohet në qarkullim një kartelë tjetër.



### Me rëndësi:

Si edhe dokumenti i deritanishëm i lejeqëndrimit, respektivisht vërtetimi mbi të drejtën e lejeqëndrimit, eAT-ja është po aq e vlefshme sa është vlefshmëria e pasaportës apo e dokumentit, i cili lëshohet në vend të pasaportës. Prandaj, luteni të keni kujdes, që të aplikoni në kohë për një pasaportë apo dokument zëvendësues, para se të vjetrit t'i skadojë afati i vlefshmërisë.

## Funksionet e eAT-së veç e veç:

1. Në çipin e eAT-së ndodhen fotografia dhe gjurmët e gishtave Tuaj. Kjo shërben për parandalimin e një keqpërdorimi të eAT-së. Me anë të funksionit biometrik ruhet gjithashtu edhe identiteti Juaj.

**Me rëndësi:**

Për fotografinë Tuaj digjitale dhe gjurmët e gishtave Tuaj kanë qasje vetëm organet kompetente si psh. policia dhe organet e Zyrës për të huaj. Zona e çipit, në të cilën janë të ruajtura këto të dhëna, është në veçanti e mbrojtur.

2. Dispozitat shtesë dhe kushtet tjera të veçanta të lejeqëndrimit, me futjen e eAT-së në qarkullim, nuk shtypen më si një etiketë shtesë dhe nuk ngjiten në pasaportë, por ruhen në çipin e eAT-së dhe shtypen në një fletë shtesë. Fleta shtesë u dorëzohet juve së bashku me eAT-në.

**Me rëndësi:**

Për dispozitat shtesë në çip kanë qasje vetëm organet kompetente si psh. policia dhe organet e Zyrës për të huaj.

3. Një mundësi e re është „legjitimimi-online“, e quajtur edhe funksioni i legjitimitit-online. Kështu Ju mund të lajmëroheni pa asnjë problem në internet apo në automatet e ndryshme dhe ta vërtetoni identitetin Tuaj. Shfrytëzimi i funksionit të legjitimitit-online ju krijon juve siguri, që përballë jush në internet është me të vërtetë personi, i cili duhet të jetë. Me anë të këtij funksioni janë të mbrojtura më së miri të dhënat Tuaja personale.

**Me rëndësi:**

Ju mund të përcaktoheni vetë, se cilat të dhëna duhet të transmetohen

4. Funksioni i ri i nënshkrimit ka të njëjtën domethënie si nënshkrimi personal. Me të Ju thjesht dhe rehatshëm mund të nënshkruani kontrata online apo kërkesa, të cilat përndryshe do të kishin vlefshmëri juridike vetëm përmes shkrimit të zakonshëm me dorë. Dokumentet e nënshkruara me dorë dhe dërgimi i mëpasëm i tyre me postë nuk janë më të nevojshme.

**Cilat të dhëna janë të ruajtura në çipin e eAT-së?**

Në çip ruhen në mënyrë të veçantë digjitale të dhënat e printuara në letër (psh. emri, mbiemri, adresa). Përveç kësaj, çipi përmban të dhëna biometrike (gjurmët e gishtave dhe fotografi) si dhe informacione dhe predispozita të tjera shtesë.



# 2 Fotografia dhe gjurmët e gishtave



Fotografia printohet në karton dhe ruhet në mënyrë elektronike në çip. Për fotografinë vlejné kushtet si më poshtë:

- Fotografia duhet të jetë e kohëve të fundit.
- Fytyra duhet të jetë qendrore dhe e pambuluar në fotografi (fotografim frontal, të mos jetë në gjysmëprofil).
- Një shami koke, e cila nuk e mbulon fytyrën, lejohet për arsye të përkatësisë fetare.
- Sytë duhet të jenë të hapura dhe të shihen qartë.
- Përjashtimet janë të mundshme për arsye mjekësore.



Informacione të tjera lidhur me kërkesat për fotografi mund të gjeni në:  
[www.bmi.bund.de](http://www.bmi.bund.de)

Për të gjithë personat e huaj të moshës gjashtë vjeçare e më sipër nga shtetet joanëtare të UE-së, në çipin e dokumentit të lejeqëndrimit duhet medoemos të ruhen dy gjurmë gishtërinjsh. Me këtë synohet të forcohet lidhja midis poseduesit të dokumenteve dhe dokumentit dhe ai të ruhet nga keqpërdorimet e mundshme.



### **A ruhen për një kohë më të gjatë gjurmët e gishtave jashtë eAT-së?**

Gjurmët e gishtave ruhen për aq kohë në Zyrën për të huajt, derisa Ju ta merrni eAT-në Tuaj. Pastaj të dhënat fshihen në mënyrë të pakthyeshme. Edhe te Shtypshkronja federale, e cila e boton eAT-në, nuk ndodh ruajtja e të dhënave Tuaja. Një bazë e të dhënave në mbarë Gjermaninë nuk është parashikuar me ligj.

### **Kush guxon të ketë qasje në fotografinë dhe gjurmët e gishtave, të ruajtura në çipin e eAT-së?**

Në fotografinë dhe gjurmët e gishtave për verifikimin e vërtetësisë së ausvajzit dhe të identitetit të poseduesit të eAT-së mund të kenë qasje vetëm organet kompetente si psh. policia dhe autoritetet e Zyrës federale për të huajt. Këtu eAT-ja duhet medoemos të jetë e deponuar në zyrën përkatëse. Leximi përmes internetit nuk është i mundshëm.

Të gjitha informacionet dhe transmetimet e eAT-së janë të mbrojtura me procedurë ndërkombëtarisht të njohur dhe të etabluar kodimi. Një sistem ndërhyrjeje, i cili bazohet në autorizimin shtetëror, e rregullon se kush në të dhënat e kujt guxon të ketë qasje në eAT.

### **Si bëhet marrja e gjurmëve të gishtave?**

Regjistrimi elektronik i gjurmëve, gjatë aplikimit në Zyrën për huajt, bëhet me ndihmën e skanerëve. Kjo ndodh pa përdorur aspak ngjyrë vule. Zakonisht secili nga dy gishtat regjistrohet tri herë. Vetëm regjistrimi më i mirë i secilit gisht ruhet.

### **Cilët gishta regjistrohen?**

Parimisht nevojiten të dy gishtat tregues për ruajtjen në eAT. Nëse është nevoja, me përjashtim të gishtave të vegjël, mund të përdoren edhe gishtat e tjerë.





# 3 Informacionet dhe predispozitat shtesë



Nëse jepen informacione dhe predispozita shtesë, atëherë të njëjtat ruhen në çip dhe printohen në një fletë shtesë. Në karton shtypet vërejtja „shih fletën shtesë“. Me ndryshimin e informacioneve shtesë lëshohet një fletë tjetër shtesë dhe ndryshohen edhe të dhënat në çip. Kështu, nuk është i nevojshëm lëshimi në qarkullim i një eAT-je të re.



### Me rëndësi:

Për informacionet dhe predispozitat shtesë në çip kanë qasje vetëm organet kompetente si psh. policia dhe organet e Zyrës për të huaj. Këtu eAT-ja duhet medoemos të jetë e deponuar në zyrën përkatëse. Leximi përmes internetit nuk është i mundshëm.

# 4 Funksioni i legjitimitit-online



## Çfarë është funksioni i legjitimitit-online?

Së bashku me një numër sekret 6 shifror funksioni i ri jua mundëson, që të legjitimoheni gjithkund online, ku ofrohen shërbime të këtilla në internet apo nëpër automate publike.

Online-shitësit, kompanitë e sigurimeve, bankat, ofruesit e emaileve apo rrjetet sociale, por edhe zyrat dhe entet e shërbimeve publike në të ardhmen do të ofrojnë më shumë shërbime të këtilla. Me këtë Ju, për shembull, do të mundeni të bëni sigurimin e automjetit Tuaj apo përmes internetit të kryeni rehatshëm me eAT-në Tuaj punë të tjera administrative, si për shembull lajmërimin e automjetit. Plotësimi i lodhshëm i formularëve, rruga për te zyrat e ndryshme publike apo kërkesat për të dhënat personale bien.

## Kush mund ta shfrytëzojë funksionin e legjitimitit-online?

Funksioni i legjitimitit-online mund të shfrytëzohet duke filluar nga mosha 16 vjeçare. Shfrytëzimi është vullnetar. Ju vetë e vendosni, nëse dëshironi ta shfrytëzoni këtë funksion. Ai mund të aktivizohet dhe çaktivizohet në çdo kohë sipas dëshirës personale.

## Si mund ta shfrytëzoj unë funksionin e legjitimitit-online?

Që të mund të legjitimohesh me eAT-në në internet, medoemos të jetë i aktivizuar funksioni i legjitimitit-online.

### Mjeti për leximin e kartelave dhe softueri i drajverave:

- Për futjen në përdorim në kompjuterin/laptopin Tuaj ju nevojitet një mjet për leximin e kartelave (të cilat mund të blihen kudo) dhe
- një softuer drajverash i ashtuquajtur „AusweisApp“, i cili mundëson lidhjen midis eAT-së dhe kompjuterit Tuaj. Softueri mund të shkarkohet në internet përmes [www.ausweisapp.bund.de](http://www.ausweisapp.bund.de).

### Letra me PIN:

Pasi të keni aplikuar për eAT-në Tuaj, do të merrni përmes postës një letër me PIN. Kjo përmban një numër sekret 5 shifror (PIN), një numër dekodimi 10 shifror (PUK) dhe një fjalëkalim dekodimi.





### **PIN-i (numri sekret):**



#### **Me rëndësi:**

PIN-i 5 shifror është një PIN-transportues dhe pas pranimit të eAT-së duhet të zëvendësohet përmes PIN-it Tuaj individual 6 shifror.

Këtë Ju mund ta bëni ose në shtëpi me anë të një mjeti për leximin e kartelave ose tek organet kompetente të Zyrës për të huaj. PIN-i mund të zëvendësohet pambarimisht nga një PIN i ri. Sa herë që Ju të shfrytëzoni funksionin e legjitimitit-online, kërkohet dhënia e këtij PIN-i individual 6 shifror.

### **PUK-u (numri i dekodimit)**

Nëse Ju e jepni tri herë gabimisht PIN-in Tuaj, ai do të bllokohet. PUK-u shërben për zhbllokimin e tij.

### **Fjalëkalimi i dekodimit:**

Nëse Juve ju është vjedhur eAT-ja apo e keni humbur atë, atëherë duhet detyrimisht ta bllokoni funksionin e legjitimitit-online. Për këtë Ju duhet t'ua thoni bashkëpunëtorëve numrin e telefonit hotline të kodimit (Sperrhotline) apo Zyrës për të huaj fjalëkalimin e dekodimit.

### **Mbrojtja e informacioneve:**

Në asnjë mënyrë të mos i shënoni PIN-in, PUK-un dhe fjalëkalimin e dekodimit në eAT dhe mos e ruani PIN-in së bashku me eAT-në.

### **Çfarë është pseudonimi?**

Me eAT-në ju mund të legjitimoheni, për shembull, në internet në rrjetet sociale, pa i dhënë me këtë rast të dhënat e Juaja personale. Çipi i eAT-së me këtë rast krijon një pseudonim të varur nga ofruesi përkatës i shërbimit, me të cilin Ju mund të identifikoheni si shfrytëzues, por i cili nuk lejon qasje në të dhënat Tuaja personale. Së bashku me PIN-in 6 shifror, kjo procedurë është po aq e thjeshtë si kyçja (log-in) e zakonshme, por dukshëm më e sigurt.

### **Çfarë është verifikimi i moshës dhe i vendbanimit?**

ër disa shërbime online, ofruesit kanë nevojë vetëm për të dhënat e moshës dhe të vendbanimit të klientit. Prandaj eAT-ja ofron një verifikim të moshës dhe vendbanimit. Për verifikimin e moshës, në vend të datës së përpiktë të lindjes, transmetohet informacioni, nëse poseduesi i eAT-së e ka arritur tashmë moshën e kërkuar (psh. 16 vjeç).

Gjatë verifikimit të vendbanimit pason vetëm një kontroll, nëse shfrytëzuesi i eAT-së është i lajmëruar në njërën nga landet federale, të dhënë nga ai.

Të dy funksionet i shërbejnë kursimit të të dhënave dhe sigurojnë se ofrohen vetëm informacionet, që nevojiten detyrimisht.

## Shfrytëzimi i funksionit të legjitimit-online, duke marrë si shembull blerjen-online



Ju jeni duke kërkuar të shitësi-online një produkt për të blerë. Shitësi-online, për lidhjen e kontratës, për kalimin e faturës dhe dërgimin e produktit ka nevojë për mbiemrin, emrin dhe adresën Tuaj. Këto informata mund të transmetohen me anë të funksionit të legjitimit-online.



Para transmetimit të të dhënave legjitimohet shitësi-online kundruall eAT-së Tuaj përmes një certifikate autorizimi. Certifikata e shitësit-online verifikohet nga eAT-ja. Sistemi i shitësit-online e verifikon, nëse eAT-ja Juaj është e vlefshme dhe nuk është e bllokuar.



Në një dritare përzgjedhëse Ju mund t'i shënjoni të dhënat, të cilat duhet të transmetohen apo në rastin e dhënë të bëni kufizimin sa më të madh të tyre. Me dhënien e PIN-it Tuaj individual 6 shifror Ju pajtoheni me transmetimin e të dhënave Tuaja. Të dhënat e lejuara i transmetohen në mënyrë të koduar shitësit-online.

Kontrata e shitblerjes lidhet përfundimisht vetëm përmes një deklaratë të veçantë të shprehjes së vullnetit të lirë për blerjen.



### Me rëndësi:

Nëse Ju e merrni dokumentin Tuaj të lejeqëndrimit gjatë ditëve në vijim, do të pyeteni, nëse dëshironi apo nuk dëshironi ta shfrytëzoni funksionin e legjitimit-online.

Ashtu siç dhe do të vendosni, do të aktivizohet apo çaktivizohet ky funksion në eAT-në Tuaj.

Nëse dikur më vonë do të vendosni ndryshe, mund ta aktivizoni apo ta çaktivizoni në çdo kohë funksionin e legjitimit-online te organet kompetente të Zyrës për të huaj.

# 5 Nënshkrimi elektronik

EAT-ja është e përgatitur për sinjaturën e kualifikuar elektronike (QES), e quajtur gjithashtu edhe funksioni i nënshkrimit. Aktivizimi i këtij funksioni mund të ndodhë vetëm, nëse vetë Ju jeni dakord për një gjë të tillë.



## Si funksionon funksioni i nënshkrimit?

Me funksionin e nënshkrimit, për shembull, mund të bëhet nënshkrimi i ligjshëm i kontratave ekzistuese digjitale. Me këtë rast, nënshkrimi i zakonshëm me dorë zëvendësohet përmes një të ashtuquajture certifikatë sinjaturimi. Sinjatura elektronike ia mundëson marrësit të një dokumenti (partnerit kontraktues) të dallojë, nëse dokumentet janë ndryshuar pas nënshkrimit digjital.

EAT-ja është e përgatitur për shfrytëzimin e nënshkrimit digjital. Për shfrytëzimin e sinjaturës elektronike duhet me patjetër të jetë i aktivizuar funksioni i legjitimitetit-online.

## Çfarë më nevojitet mua, që të mund ta shfrytëzosh funksionin e nënshkrimit?

Çdo shfrytëzues i eAT-së mund ta shfrytëzojë funksionin e nënshkrimit sipas dëshirës së vet. Për këtë ai duhet të aplikojë për një certifikatë të posaçme sinjaturimi dhe për një mjet komfort leximi. Varësisht prej ofruesit sillel edhe kostoja e përgjithshme.

### Certifikata e sinjaturimit:

Për marrjen e kësaj certifikate duhet të bëhet aplikimi te një ofrues i lejuar sinjaturimi (i quajtur edhe ofruesi i shërbimit të sinjaturimit). Një listë e këtyre ofruesve e gjeni në internet në faqen zyrtare të Agjencisë federale të informimit ([www.nrca-ds.de](http://www.nrca-ds.de)) nën pikën „Akkreditierte ZDA“. Ju duhet ta instaloni certifikatën e sinjaturimit në eAT-në Tuaj.





**PIN-i i sinjaturimit:**

Për shfrytëzimin e funksionit të nënshkrimit ju nevojitet një PIN i veçantë i sinjaturimit, të cilin ju e vendosni vetë pas instalimit të certifikatës së sinjaturimit.

**Mjeti komfort i leximit:**

Juve ju nevojitet një mjet komfort i leximit me një PIN-Pad dhe ekran, i cili është i sajuar apostafat për kartela me çip. Luteni që ta merrni parasysh udhëzuesin e shfrytëzimit të softuerit përkatës.



# 6 Mundësi të reja përdorimi për dokumentin e lejeqëndrimit Tuaj



## Sferat e shfrytëzimit të funksionit të legjitimitit-online

**Regjistrimi online:** Gjatë regjistrimit të parë në një shërbim-online, shpesh kërkohen shumë të dhëna mbi përdoruesin. Mund të jetë emri, por në disa raste edhe adresa e plotë e tij. Këto të dhëna mund të transmetohen shpejt dhe pa gabime me anë të eAT-së.



**Legjitimimi në automatet publike:** Edhe në automatet e informimit dhe shitjes do të ofrohen në të ardhmen më shumë shërbime të personalizuar. Këtu Ju me eAT-në Tuaj mund të legjitimoheni gjithashtu shpejt dhe thjesht.



**Qasja me pseudonim:** Jo gjithmonë duhet të transmetohen në internet të dhënat personale. Megjithatë, është e kuptueshme, që shërbimet përsëri „t'i rinjohin“ shfrytëzuesit e tyre, për shembull, nëse ata tashmë janë regjistruar paraprakisht. Për këtë qëllim eAT-ja krijon një pseudonim.



**Firmosja-online:** Me funksionin e nënshkrimit apo të sinjaturimit Ju mund të lidhni pa problem kontrata online.



**Verifikimi i moshës apo i vendbanimit:** Disa nga shërbimet duhet të merren parasysh vetëm nga përdoruesit, të cilët kanë arritur një moshë të caktuar apo janë të lajmëruar në një vendbanim të caktuar. eAT-ja mund ta vërtetojë moshën apo vendbanimin, pa qenë nevoja të jepjen të dhëna të tjera. Bëhet transmetimi vetëm me një „po“ ose „jo“.



**Plotësimi automatik i formularëve:** Plotësimi i formularëve-online shpesh është i mundimshëm. Shpejt ndodhin gabime daktilografimi gjatë dhënies së emrit dhe adresës. Funksioni i legjitimitit-online e mundëson marrjen e të dhënave nga eAT-ja.

**Formularët në administratën publike:** Organet e shërbimeve publike në të ardhmen do t'i ofrojnë shërbimet e tyre edhe në internet (për shembull, postimin elektronik të deklaratës mbi tatimin). Për këto oferta nevojitet dëshmimi i sigurt i identitetit të përdoruesit. Funksioni i legjitimitit-online në të ardhmen mund ta marrë përsipër këtë gjë.

# 7 Siguria e të dhënave

## Cilat të dhëna transmetohen me anë të eAT-së?

Me dhënien e PIN-it Ju i mund t'i jepni të dhënat si më poshtë:

- Emri dhe mbiemri, sipas rastit edhe titulli i doktorit të shkencave
- Shteti i cili e ka lëshuar dokumentin
- Verifikimi i moshës apo i vendbanimit
- Datëlindja dhe vendi i lindjes
- Adresa
- Lloji i dokumentit
- Pseudonimi

## E drejta Juaj e pakontestueshme - dhënia e informacioneve me vullnet të lirë

Më në fund jeni Ju si posedues i eAT-së ai, i cili e përcakton se cilat të dhëna duhet të transmetohen. E dhëna, nëse eAT-ja Juaj është e vlefshme, transmetohet në çdo rast. Kjo vlen edhe për tiparin e bllokimit. Ai lë të dallohet, nëse eAT-ja Juaj është e bllokuar ose jo.

## Janë të dhënat e mia të siguruar?

Po! Të dhënat e Juaja personale janë madje më të siguruar, se sa kur Ju lëvizni në internet pa eAT-në Tuaj, blini aty ose jeni aktiv në rrjetet e ndryshme. Funkcionet e saj të reja i mbrojnë të dhënat Tuaja personale. Funkcioni i legjitimitetit-online e verifikon, nëse ofruesi-online është me të vërtetë ai, për të cilin ai pretendon se është.

## A janë të dhënat gjatë transmetimit të siguruar nga hakerat?

Gjatë çdo transmetimi të të dhënave të dhënat Tuaja janë të koduara. Të gjitha informacionet dhe transmetimet janë të mbrojtura me procedura kodimi, të njohura dhe të etabluara ndërkombëtarisht.

Çdo ofrues, i cili për shërbimet e tij dëshiron ta shfrytëzojë eAT-në, duhet detyrimisht të aplikojë për një certifikatë përkatëse shtetërore autorizimi në Zyrën për dhënien e certifikatave të autorizimit (VfB). Kjo zyrë verifikon në parakushte të rrepta, se cilat të dhëna kërkohen detyrimisht, për ta realizuar shërbimin dhe jep autorizim vetëm për këto të dhëna.





# 8 Çfarë ndodh në rast vjedhjeje apo humbjeje?



## Si mund t'i bllokoj unë funksionet elektronike, nëse e humbas eAT-në time apo ma vjedhin atë?

Ju mund ta bllokoni funksionin e legjitimitetit-online përmes linjës telefonike **Hotline 0180-1 33 33 33** (3,9 centë/minuta nga telefonia fikse gjermane, maksimalisht 42 centë/minuta nga rrjeti i telefonisë celulare - e kapshme edhe jashtë Gjermanisë). Aty Ju do të pyeteni për emrin Tuaj, datëlindjen dhe për fjalëkalimin e bllokimit. Kështu nuk mundet askush tjetër përpos Jush që ta bllokojë eAT-në Tuaj. Në këtë rast duhet të informohet Zyra përgjegjëse për të huajt për humbjen e eAT-së. Në mënyrë alternative mund t'i drejtoheni drejtpërdrejt edhe Zyrës për të huajt dhe ta lajmëroni eAT-në si të humbur.

## Çfarë ndodh me funksionin e nënshkrimit, nëse unë e humbas eAT-në?

Ju duhet menjëherë ta lajmëroni humbjen te ofruesi i Juaj i sinjaturimit dhe ta bllokoni funksionin e nënshkrimit. **Kjo nuk ndodh automatikisht, kur ta lajmëroni humbjen e dokumentit Tuaj te Zyra për të huajt. Ju detyrimisht duhet t'i drejtoheni edhe ofruesit Tuaj të sinjaturimit.**

# 9 Çfarë ndodh, nëse ... ?

## **... e jap gabimisht PIN-in?**

Pas dhënies së gabueshme për së dyti herë, softueri kërkon nga Ju, që ta jepni numrin Tuaj të kalimit. Këtë Ju e gjeni te ana e përparme e eAT-së Tuaj.

Pas dhënies së gabueshme për së treti herë, funksioni-online bllokohet për shkaqe sigurie. Në këtë rast ju mund ta zhblokoni atë me anë të numrit zhblokues (PUK). PUK-u mund të përdoret deri në dhjetë herë.

## **... e harroj PIN-in?**

PIN-i mund të merret rishtas në çdo Zyrë për të huaj. Ju vetëm duhet që ta keni me vete eAT-në Tuaj.

## **... shpërngulem?**

Në këtë rast Ju duhet të shkoni t'i kontaktoni autoritetet përkatëse (Zyrën për të huaj apo autoritetet komunale) për rilajmërimin në adresën Tuaj të re. Ata e ndryshojnë adresën në çip dhe në pjesën e dukshme të eAT-së.

## **... pasaporta ime nuk është më e vlefshme?**

Aplikoni në kohë për një vazhdim të afatit të pasaportës Tuaj. EAT-ja Juaj e ardhshme mund të jetë për aq kohë e vlefshme, sa është e vlefshme edhe pasaporta Juaj.

## **... dëshiroj ta aktivizoj apo çaktivizoj me vonesë funksionin e legjitimitit-online?**

Ju mund ta aktivizoni apo çaktivizoni në çdo kohë funksionin e legjitimitit-online në Zyrat përkatëse për të huajt, për aq sa është e vlefshme eAT-ja Juaj.



# 10 Ne jemi gjithmonë aty për Ju!

## – Zyra për të huajt –

Aplikimi për dokumentin e lejeqëndrimit bëhet në Zyrën vendore përkatëse për të huajt. Më shumë informacione lidhur me procedurën e aplikimit mund të merrni aty.



Ju mund t'i drejtoheni me telefon shërbimit për qytetarët. Shërbimi për qytetarët punon nga e hëna në të premte prej orës 7.00 deri në orën 20.00 dhe mund të telefononi në çdo kohë në numrin 0180 - 1 33 33 33 (3,9 centë/minuta nga telefonia fikse gjermane, maksimalisht 42 centë/minuta nga rrjeti i telefonisë celulare - e kapshme edhe jashtë Gjermanisë).

## – Informatat në internet –

Në Internet mund t'i gjeni rishitas të gjitha informacionet e përmbledhura nën [www.bamf.de/eaufenthaltstitel](http://www.bamf.de/eaufenthaltstitel). Ndhimesë mund të japin edhe përgjigjet lidhur me pyetjet e rëndësishme. Ndërkohë që në internet ka udhëzime, si për shembull, për ofruesit e shërbimeve të sinjaturimit ose për shkarkimin e softuerit „AusweisApp“.

Shkurtesat	
eAT	elektronischer Aufenthaltstitel (elektronska boravišna dozvola)
PIN	Personal Identification Number (numri sekret)
PUK	Personal Unblocking Key (numri i dekodimit)
QES	Qualifizierte elektronische Signatur (Sinjatura e kualifikuar elektronike)
VfB	Vergabestelle für Berechtigungszertifikate (Zyra për dhënien e certifikatave të autorizimit)



## Treguesi i botimit

**Botuesi dhe redaksia:**

Zyra federale për migrim dhe refugjatë,  
referati 230 Ministria e brendshme, referati MI 6  
dhe referati IT 4

**Gjendja:**

Shkurt 2011

**Shtypi:**

Bonifatius GmbH  
33100 Paderborn

**Strukturimi:**

Zyra federale për migrim dhe refugjatë  
Gertraude Wichtrey  
Claudia Sundelin